Funded by the European Union

Mbështetje për ndryshimin e sjelljes tek banorët për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Prespës



Duration: 01.01.2025 - 30.06.2027

Countries:
North Macedonia

EU contribution: € 197 554

Total budget: € 219 505

Implementer:
INSTITUTE OF COMMUNICATION STUDIESSKOPJE

Social media:
facebook.com/presparazbudise,
instagram.com/presparazbudise/

Website(s): presparazbudise.mk/

Project description:

Projekti “Mbështetja e Ndryshimit të Sjelljes tek Banorët për të Përmirësuar Menaxhimin e Mbeturinave në Rajonin e Prespës” synon të forcojë zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor duke promovuar menaxhimin e përgjegjshëm të mbeturinave të ngurta në komunitetet lokale. Përmes fushatës së synuar për ndërgjegjësim të publikut, iniciativa do të edukojë banorët rreth pasojave mjedisore dhe shëndetësore të asgjësimit të papërshtatshëm të mbeturinave, duke inkurajuar njëkohësisht kuptim dhe zbatim më të madh të praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave. Projekti synon të rrisë ndërgjegjësimin për përgjegjësinë individuale dhe kolektive, si dhe të inkurajojë ndryshimet në sjellje që do të kontribuojnë në një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm në Rajonin e Prespës.

Expected results:

•Nivel më i lartë i ndërgjegjësimit publik: Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë lokale ka kuptim më të mirë të praktikave të qëndrueshme për menaxhim të mbeturinave dhe ndikimit të asgjësimit të papërshtatshëm të mbeturinave në mjedisin jetësor;
•Ndryshimi në sjelljen mbi menaxhimin e mbeturinave: Ndryshime pozitive të dukshme në zakonet e qytetarëve për menaxhimin e mbeturinave, përfshirë rritjen e shkallës së riciklimit, uljen e mbeturinave dhe menaxhimin më të përgjegjshëm të mbeturinave shtëpiake;
•Pjesëmarrja aktive e komunitetit: Rritja e nivelit të përfshirjes së qytetarëve në aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, siç janë aksionet për pastrim, punëtoritë dhe fushatat ndërgjegjësuese;
•Mbështetje për infrastrukturë më të mirë për menaxhim me mbeturina: Bashkëpunim më i mirë midis qytetarëve dhe institucioneve lokale, duke kontribuar në shërbime lokale më efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave;
•Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve edukative: Hartimi dhe ndarja e përmbajtjeve edukative (fletëpalosje, afishe, video, materiale shkollore) që do të mundësojnë të nxënit e vazhdueshëm dhe përfshirjen e komunitetit;
•Vlerësime fillestare dhe pasuese të kryera: Kryerja e hulumtimeve dhe kryerja e vlerësimeve për të vlerësuar ndryshimet në njohuritë, qëndrimet dhe sjelljen e qytetarëve, me qëllim sigurimin e të dhënave për vlerësimin e suksesit të projektit.